

SJELLJET E PAPËRSHTATSHME TË NXËNËSVE NË SHKOLLË DHE MENAXHIMI I TYRE NGA ANA E MËSIMDHËNËSVE

Luljeta Shala¹

Ismet Potera²

Abstrakt

Sjelljet jo të mira të nxënësve në shkollë janë bërë dukuri e përditshme në medie dhe në diskursin e zakonshëm të komunikimit, aktorëve të ndryshëm: prindër, mësues dhe profesionistë. Qëllimi i hulumtimit ishte identifikimi i sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve në shkollë, përmes perceptimit të mësimeve dhe të nxënësve dhe përcaktimit të teknikave për menaxhimin e sjelljes së papërshtatshme të nxënësve në shkollë.

Qasja e përzier, sasiore dhe cilësore dhe përshkruese e vlerësuese, është përdorur për realizimin e hulumtimit. Të dhënat sasiore u grumbulluan nga mësimeve dhe nxënësve përmes Google form dhe përmes postës elektronike. Mostra e rastit përbëhej nga 93 mësimeve të lëndëve të ndryshme dhe 103 nxënës të SHMU.

Nga analiza e të dhënave shohim se si nga mësimeve, ashtu edhe nga nxënësve, sjellje të papërshtatshme në orë mësimore konsiderohen zhurma në klasë, lëvizjet e parregullta, bisedat anësore, përdorimi i telefonave, ngacmimet, gjuha urrejtëse ofenduese etj. Vërejmë dallime ndërmjet mendimeve të mësimeve dhe nxënësve sa i përket sjelljes së papërshtatshme, përkatësisht gjuhës urrejtëse, ofenduese, dhe menaxhimit të tyre në orë mësimore. Rreth 61% e mësimeve mendojnë se gjuha urrejtëse, ofenduese, është sjellje e papërshtatshme e nxënësve në orë mësimore, ndërsa po për këtë 32% e nxënësve mendojnë se është sjellje e papërshtatshme në orë mësimore. Në anën tjetër, nxënësve në përqindje më të madhe (rreth 56%) kërkojnë më shumë vëmendje për këto sjellje, ose për menaxhimin e tyre në klasë. Sipas mësimeve (52%) dhe nxënësve (56%), moshën më problematike për këto sjellje është ajo 14 -16 vjeç.

Thellimi i të kuptuarit profesional të shkaqeve të sjelljeve do të ndihmojë mësimeve të hartojnë programe për parandalimin e tyre. Njohja me llojin e sjelljes dhe shkakun pse veprojnë ashtu është një mekanizëm i mirë për menaxhimin e këtyre sjelljeve.

Fjalët çelës: mësimeve, menaxhim i sjelljes, nxënës, sjellje e papërshtatshme, shkaqet e sjelljes.

¹ Hulumtuese në IPK

² Hulumtues në IPK

MISCONDUCT OF STUDENTS IN SCHOOL AND ITS MANAGEMENT BY TEACHERS

Abstract

Student misbehavior at school has become a daily occurrence in the media and in the common communication discourse of various actors: parents, teachers and professionals. The aim of the research was to identify, through the perception of teachers and students, inappropriate behaviors of students in school and to define strategies for the management of improper conduct of students in school. The analysis was carried out by the mixed approach of quantitative and qualitative, descriptive and evaluative methods. Teachers and students obtained quantitative data through Google forms and email. The random sample consisted of 93 teachers of different subjects and 103 students of SHMU. The findings show that inappropriate behavior in the classroom is considered by both teachers and students as classroom noise, irregular movements, side conversations, telephones, bullying, hateful or offensive language, etc. We note differences between teachers' and students' opinions about inappropriate behavior, namely hateful and offensive language and their classroom management. About 61% of teachers think that hateful offensive language is inappropriate behavior of students in the classroom, while, for the same reason, 32% of students think that it is inappropriate behavior in the classroom. On the other hand, students in a larger percentage (about 56% of students) require more attention to these behaviors, or to their management in the classroom. According to teachers (52%) and students (56%) the most problematic age for these behaviors is 14-16 years old. Therefore, teachers can design programs for their prevention by deepening professional understanding of the causes of behaviors. A good mechanism for managing these behaviors is knowing the type of behavior and why they act so.

Keywords: teacher, behavior management, student, inappropriate behavior, causes of behavior

HYRJE

Në klasë paraqiten probleme të llojllojshme dhe të natyrave të ndryshme, por më së shpeshti i hasim kur mësimdhënësit punojnë në klasë me nxënësit e moshave të ndryshme, që janë në fazën e adoleshencës. Janë të ndërgjegjshëm se do të përballen me paraqitje dhe situata të vështira, të cilat duhen trajtuar me kujdes, me qëllim që të ruhet klima pozitive në mësim dhe të ndihmohen nxënësit që të prezantojnë një sjellje të pëlqyeshme në mjedisin e klasës, ku ata kalojnë një pjesë të madhe të angazhimit aktiv të kohës së tyre. Sjelljet e papërshtatshme në klasë janë ato sjellje që prishin, pengojnë apo ndalojnë mësimdhënien dhe të nxënësit. Ato janë rezultat i përvojave negative në mjedisin rrethues. Për Hirschin (2017), themeluesin e teorisë së kontrollit shoqëror, sjelljet devijuese/të papërshtatshme janë produkt i nxitjeve të natyrës njerëzore dhe shumica prej nesh arrijmë t'i kontrollojmë këto sjellje falë lidhjeve personale që i krijojmë me vlerat, njerëzit dhe institucionet pro-sociale (Hirschin, 2017).

Strategjitë për të inkurajuar sjellje sociale të përshtatshme mund të dështojnë, kështu që mësuesit me shprehje të zhvilluara menaxhuese përdorin gjithashtu teknika efektive për të minimizuar sjelljen e papërshtatshme, duke krijuar mjedise të të nxënësit dhe klimë më pozitive në klasë.

Aftësia e mësuesve për të organizuar klasën dhe për të menaxhuar sjelljet e nxënësve të tyre është kritike për të arritur objektivat e mësimin. Megjithatë menaxhimi i sjelljes nuk garanton mësimdhënie efektive, ai bën të mundur krijimin e një ambienti të të nxënësit, që favorizon mësimdhënien e suksesshme. Menaxhimi i sjelljeve jo të përshtatshme në klasë realizon gjithë përfshirjen në procesin mësimor, duke iu dhënë mundësi edhe nxënësve me vështirësi në të nxënë të marrin pjesë aktive në nxënie.

Për mësuesit e rinj, përgatitja profesionale joadekuade është një nga faktorët kryesorë që i kontribuon përballjes me sjellje jo të përshtatshme të nxënësve në klasë. Për këto arsye, sidomos për mësuesit e rinj, por edhe për ata me përvojë, trajnimi i vazhdueshëm me tematikë “menaxhimi i klasës” është i domosdoshëm. Do të ishte mirë nëse edhe fakultetet që përgatisin mësues të

përfshijnë në kurrikulat e tyre njohuri dhe shprehje të menaxhimit të sjelljeve jo të përshtatshme të nxënësve në klasë, sepse do t'u ndihmonte shumë mësuesve në të ardhmen.

Konteksti teorik

Sjelljet e gabuara të nxënësve, si të folurit çrregullues, shmangia kronike nga puna, ndërhyrja në aktivitete mësimore, ngacmimi i shokëve të klasës, fyerjet verbale, vrazhdësia ndaj mësuesit, krijimi i armiqësisë sipas Reedand & Kirkpatrick (1998), fillon njëherë më rrallë dhe shkon tek e shpeshta, e buta deri tek e rënda, dhe kjo është çështje që ndodh pothuajse çdo ditë në klasë. Mësuesit zakonisht raportuan se këto sjellje shqetësuese në klasë janë të patolerueshme (sipas Johnson and Fullwood, 2006) dhe që shkaktojnë stresin Lewis (1999) dhe atyre u duhej të shpenzonin një kohë dhe energji të madhe për të menaxhuar klasën (Leung and Ho, 2001). Natyrisht, sjelljet e gabuara të nxënësve prishin qetësinë dhe efektivitetin e mësimdhënies dhe gjithashtu pengojnë mësimin e nxënësve dhe shokëve të tij/saj të klasës. Për më tepër, rezultatet e hulumtimit kanë treguar që sjellja e keqe në shkollë jo vetëm që u përshkallëzua me kohën, por gjithashtu uli arritjet akademike dhe rriti sjelljen e delikuentës sipas (Weerman, Harland and vander Laan, 2007). Për të pakësuar këto ndikime të menjëhershme dhe graduale të sjelljeve keqbërëse të nxënësve, është me rëndësi parësore të përcaktoni se cilat janë saktësisht këto sjellje brenda klasës. Në literaturë, terma të ndryshëm janë përdorur për të përshkruar sjelljet problematike të nxënësve. Për shembull, Stewart & Ho (2004) iu referua sjelljeve të gabuara të nxënësve në shkollë disiplinore në shkollë, ngurtësi, vandalizëm, mbrojtje, vjedhje dhe pirje në kampus. Kur ekzistojnë rregulla të qarta në shkollë dhe në klasë, shkelja e tyre është me sa duket një "sjellje e gabuar ose prishje discipline". Sidoqoftë, një sjellje e veçantë konsiderohet si problematike dhe bën thyerje të rregullave, por është e papërshtatshme ose shqetësuese në klasë. Për shembull, fjetja në klasë, mospërfundimi i detyrave të shtëpisë, biseda në klasë, prishja e mësimin, ngacmimi dhe vrazhdësia ndaj mësuesit, quhen "sjellje problemi" (Ho, 2004), "probleme të sjelljes" (Wheldall and Morrett, 1988) ose "sjellje shqetësuese".

Parandalimi dhe korrigjimi i sjelljeve jo të përshtatshme të nxënësve në klasë duhet të nisë që në klasën e parë, mundësisht edhe më herët, në edukimin parashkollor. Sipas autorëve Walker, Colvin dhe Ramswy (1995), “nëse sjellja antisociale nuk ndryshon deri në fund të klasës III, ajo duhet të trajtohet si një dukuri kronike, tamam si diabeti, i cili nuk mund të kurohet, por vetëm mund të mbahet nën kontroll” (Walker, Colvin & Ramswy 1995). E rëndësishme është që “kurimi” i sjelljeve jo të përshtatshme të nxënësve të ndërmerret në nivel shkolle dhe jo në nivel klase. Ai duhet ndërmarrë me pjesëmarrjen e të gjithë stafit dhe jo vetëm të një pjese dhe përfshirja në këtë proces edhe e prindërve do ta lehtësonte shumë atë dhe do të jepte rezultate. Kur mjedisi shkollor është i sigurt, pozitiv dhe bashkëpunues, promovimi i sjelljeve pozitive nga njëra anë, por sidomos izolimi dhe korrigjimi i sjelljeve negative, do të realizoheshin më lehtë.

Për të arritur këtë synim, shkolla duhet të adoptojë disa praktika që kanë dhënë rezultate:

- Identifikimi i sjelljeve pozitive në nivel klase dhe shkolle;
- Identifikimi i shembujve të sjelljes pozitive për çdo pritje që zëvendësojnë sjelljet jo të përshtatshme;
- Mësimdhënia dhe praktikimi i pritjeve në fillim të vitit shkollor, por edhe në vijimësi;
- Përdorimi i veprimtarive efektive që inkurajojnë dhe përforcojnë sjelljen e mirë sociale;
- Përdorimi i praktikave të evidentuara për të dekurajuar sjelljet e papërshtatshme;
- Monitorimi i zbatimit të planit shkollor mbi bazën e të dhënave.

Ata mësimdhënës që nuk bëjnë përpjekje t’i kuptojnë shkaqet e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve në shkollë rrezikojnë shumë në uljen e autoritetit të vet edukativo-mësimor, ftohjen e marrëdhënieve nxënës-mësimdhënës, uljen e autoritetit edukativ të shkollës në përgjithësi, si dhe zvogëlimin e mundësive të saj që të edukojë dhe të formojë një personalitet të zhvilluar e të përgatitur për një jetë më të mirë e më të begatshme. Nëse

ftohen marrëdhëniet nxënës-mësimdhënës, efekti i punës edukativo-mësimore do të ulet fare dhe mësimdhënësi do të bjerë në ato pozita ku autoritetin e vet e mbështet në veprimin më të ulët, përmes ndëshkimit të nxënësve me nota të dobëta, pa u përpjekur aspak që të kuptojë gjendjen e nxënësit, i cili ka rënë në një pozitë të tillë të pa lakmueshme e devijuese dhe brenda mundësive t'i ndihmojë atij që të tejkalojë atë gjendje. Mësimdhënësi që mbështet autoritetin e vet përmes ndëshkimit të nxënësve me nota të dobëta e me masa tjera joadekuate nuk bën përpjekje fare që t'i kuptojë shkaqet e sjelljeve devijante të nxënësit dhe t'u ndihmojë sadopak atyre që të dalin nga ajo gjendje jo e lakmuar, për të cilën më së paku janë fajtorë ata (Cangelosi, 2008).

Ai që është mësimdhënës i mirë bën përpjekje të vazhdueshme t'i kuptojë sa më shumë e sa më drejt shkaqet e sjelljeve të secilit nxënës, që t'u dalë në ndihmë atyre sipas nevojës që kanë, për t'i nxjerrë sadopak nga pozita e tyre jo e lakmuar, e cila shkakton sjellje devijante të nxënësit.

Mësimdhënësi i mirë merr informacion të mjaftueshëm për gjendjen dhe rrethanat e nxënësit në familje e në shkollë, se a i ka komplet familjen dhe dy prindërit, a i mungon ndonjëri prej prindërve, nëna apo babai, a i ka të divorcuar prindërit, si është gjendja shëndetësore dhe ekonomike në familje, si janë raportet në mes dy prindërve dhe në mes prindërve e fëmijëve dhe si është gjendja shëndetësore e vetë nxënësit? Po ashtu, merr informacion edhe për raportet e nxënësit me shokë e shoqe dhe në mes arsimtarëve tjerë, që të ketë një qasje më profesionale e pedagogjike ndaj kësaj kategorie nxënësish që duan përkujdesje të veçantë (Longman & Hayden, 2007).

Shumë nxënës kanë probleme të ndryshme psikologjike, që shkaktohen për shkak të frikësimeve, hidhërimeve, pikëllimeve, zemërimeve të ndryshme dhe për shkak të tensioneve emocionale dhe streseve të jetës së tyre, të cilat janë të domosdoshme të kuptohen drejt nga ana e mësimdhënësit, që të ketë një qasje më të përkushtuar ndaj nxënësit.

Mësimdhënësi i mirë duhet t'i kuptojë dhe t'i respektojë dallimet në mes të nxënësve për nga inteligjenca e tyre, për nga talenti, motivacioni, dëshira, aspirata dhe kureshtja, që t'i trajtojë profesionalisht dhe t'u japë kurajë e forcë për mësim e për jetë (Pearson & Fontana, 1994).

Mësimdhënësi bën përpjekje që të kuptojë sa më shumë e sa më drejt se ndër shkaqet e sjelljeve devijuese të nxënësve në shkollë mund të jetë mënyra e përkujdesjes familjare ndaj fëmijës, kualiteti i punës së mësimdhënësit në lëndët mësimore, mënyra e sjelljes së tyre si mësimdhënësi e si edukator, numri i madh i nxënësve nëpër klasë, mungesa e kabineteve shkollore dhe pajisjes së tyre me mjete të duhura mësimore, regjistrimi, vlerësimi dhe kalimi i nxënësve pa respektimin e kriterëve të duhura pedagogjike-psikologjike. Mënyra se si udhëtojnë nxënësit deri në shkollë, mënyra e funksionimit apo mosfunksionimit të shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkollë, i cili mungon në shumicën e institucioneve arsimore të ne, si dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në mënyrën e sjelljes së nxënësve në shkollë.

Të gjithë këta faktorë që u përmendën më lart ndikojnë në një mënyrë apo tjetër në formimin e personalitetit, tipareve dhe karakterit të nxënësve, të cilat manifestohen përmes sjelljeve të tyre dhe për çudi, në fund të fundit, pa fajin e nxënësit, më së shumti fajësohet, përbuzet, lihet pas dore dhe ndëshkohet nxënësi, përmes notës dhe ndëshkimeve tjera joadekuate, që është një padrejtësi e madhe, e cila po i bëhet nxënësit në dëm të lirive dhe të drejtave të tij personale.

Nuk mund ta mohojmë faktin se në shkolla po paraqiten sjellje jo të mira të nxënësve. Kjo reflektohet me mungesën e interesit të tyre për të përmbushur detyrat që u takojnë si nxënës. Madje, kjo “shthurje” është reflektuar edhe me probleme më serioze. Të tilla janë ato në marrëdhëniet mësues-nxënës, si edhe në marrëdhëniet ndërmjet vetë nxënësve. Si rrjedhojë, krahas të tjerave, vëmë re edhe një rritje të braktisjes së shkollimit nga ana e nxënësve. Problemi që diktojmë pranohet, jo vetëm nga mësuesit pa shumë përvojë, por edhe nga ata që kanë një përvojë të gjatë në mësimdhënie. Këtë mendim e kanë gjithashtu edhe specialistë të tjerë të arsimit dhe shumë prindër arsimdashës. Ky fenomen po bëhet i prekshëm thuajse në të gjitha shkollat tona. Pra, ka pësuar një shtrirje të gjerë. Sigurisht që nxënësit, duke qenë të paimentuar për cilësinë e mësimdhënies dhe të edukimit, dëmtojnë jo vetëm veten, por edhe krejt sistemin arsimor dhe edukativ. Kjo problematikë duhet vlerësuar nga të gjitha grupet e interesit, që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë në drejtimin e arsimit dhe edukimit të fëmijëve në shkolla. Opinioni i shëndoshë pedagogjik pranon se nxënësit e dikurshëm, krahasuar

me të sotmit, i vlerësonin më shumë shkollën dhe mësimdhënien. Gjithashtu, tregonin më shumë respekt për figurën e mësuesit dhe prindit. Ka pasur më shumë harmoni dhe mirëkuptim edhe në mes të nxënësve, por ka disa faktorë kryesorë që kanë çuar në këtë situatë. Prezenca në shkolla e një kuadri jo të devotshëm për të kryer detyrën e mësuesit është një faktor kryesor. Një faktor tjetër është reforma e shkuar arsimore që nuk i përshtatet kontekstit. Po kështu, një faktor tjetër i rëndësishëm është ndjenja e (pa)përgjegjësisë së prindit ndaj fëmijës. Nga përvoja mund të themi së kemi hasur shumë prindër që nuk kanë ndjenjë përgjegjësie dhe interes të duhur në ndjekjen e sjelljes së fëmijës në shkollë. Këta prindër nuk i marrin seriozisht detyrimet që u takojnë dhe mundohen që këto detyrime t’ua kalojnë mësuesve. Padyshim bëhet fjalë për prindër që u mungon formimi i duhur për t’i dhënë vlerësimin e merituar shkollës për pjesën që u takon.

Zhvillimi i punës edukativo-arsimore në shkollë, në familje, në rrugë dhe gjetiu, është shumë punë e vështirë. Kërkon angazhim, kohë, punë, lodhje, shqetësim, por edhe përpos gjitha këtyre që u potencuan më lart, është kënaqësi, nder dhe respekt i posaçëm për mësimdhënësin. Prindërit dhe tërë familja me një fjalë ta kanë besuar fëmijën e tyre për ta udhëhequr, mësuar, përgatitur, drejtuar dhe udhërrëfyes në jetë. Gjënë, pasurinë më të dashur, produktin më të çmuar-fëmijën e tyre kur ta beson dhe ta dorëzon në ndërgjegjen dhe vetëdijen tënde për të menaxhuar gjatë kohës së tij në shkollë (Mohamed, 2012).

Praktika e menaxhimit të sjelljeve të nxënësit në shkollë paraqet një mori strategjish për të trajtuar problemet që mund të shfaqen gjatë mësimdhënies dhe zhvillimit të procesit edukativ në klasë. Në klasë paraqiten probleme të llojllojshme dhe të natyrave të ndryshme, por më së shpeshti i hasim kur mësimdhënësit punojnë në klasë me nxënësit e moshave të ndryshme, që janë në fazën e adoleshencës, janë të ndërgjegjshëm se do të përballen me paraqitje dhe situata të vështira, të cilat duhen trajtuar me kujdes, me qëllim që të ruhet klima pozitive në mësim dhe të ndihmohen nxënësit që të prezantojnë një sjellje të pëlqyeshme në mjedisin e klasës, ku ata kalojnë një pjesë të madhe të angazhimit aktiv të kohës së tyre.

Formulimi dhe kuptimi i plotë i konceptit, menaxhimi i sjelljeve të nxënësit, evidenton faktin e nevojës që duhet të ketë mësimdhënësi për të bashkëvepruar dhe për të realizuar integrimin e të gjitha strategjive të mundshme analitike-metodike-didaktike të administrimit, me qëllim që të arrijë të zgjedhë nga e tërë kjo mori strategjish atë që është më e afërt dhe më aplikative për momentin në mjedisin e shkollës. Përgatitja e duhur dhe në nivel e më shumë strategjive menaxhuese të sjelljes së nxënësit nga ana e mësimdhënësit është një veprim i suksesshëm, që i mundëson atij që kur strategjia e parë nuk funksionon të përdorë formën e dytë, që të jetë e suksesshme në administrimin e klasës (Burden, 1995).

Procesi i menaxhimit të sjelljeve të pahijshme dhe problematike të nxënësit që si përkasin atij në klasë nënkupton, zakonisht, jo marrjen me emra ose më mirë të themi me emër dhe mbiemër nxënësin problematik, por trajtimin e strategjive të administrimit të sjelljes, kryesisht në planin e përgjithshëm, nëpërmjet analizave të problematikës së sjelljes negative, që mund të lindin në mjedisin shkollor. Qëllimi ynë është që ky proces i administrimit të sjelljeve të kuptohet nga mësimdhënësi se filozofia e menaxhimit të sjelljes së nxënësve në shkollë paraqet një problem delikat dhe të vështirë.

Mësimdhënësi gjatë zhvillimit të procesit edukativo-arsimor ndeshet edhe me raste kur sjellja problematike e nxënësit është produkt i faktorëve të streseve objektive dhe subjektive dhe nxënësi për shkaqe të ndryshme nuk i shpreh dhe paraqet për të qenë i qetë dhe për ta kuptuar të tjerët, të cilët vijnë nga abuzimi i shokëve dhe i më të rriturve, papunësia e prindërve, mosrealizimi ose mosarritja e tërë asaj që del nga kërkesat në shkollë, angazhimi pa masë i fëmijëve në punë dhe në biznesin e prindërve, humbja e një njeriu të dashur dhe të afërt në familje, problemet dhe mosmarrëveshjet e përditshme në familje, divorci, mosrespektimi i kërkesave në përputhshmëri me moshën e adoleshentit (Wiley & Chambers, 1999).

Këta dhe shumë faktorë tjerë që ngrinin dhe krijojnë strese, ku nxënësi përjeton prirjen për të shfaqur një sjellje agresive në mjedisin e shkollës. Kjo situatë kërkon sjellje dhe menaxhim profesional, duke u kuptuar në kohë dhe me përkushtim nga ana e mësimdhënësit, mund të menaxhohet me lehtësi nëpërmjet krijimit të mbështetjes së nevojshme pedagogjike. Angazhimi dhe

ndërhyrja me kohë ndaj këtij qëndrimi bën reduktimin e ndikimit të faktorit që prodhon stresse dhe mënjanohet drejt transformimit në një sjellje të mirë dhe pozitive. Probleme paraqiten kur, edhe përpos sjelljeve dhe angazhimeve, sjelljet negative vazhdojnë të jenë prezent edhe më tutje te nxënësi. Në situata të tilla kërkohet diskutim me drejtuesit e shkollës, shërbimin social-pedagogjik-psikologjik, mësimdhënës më të vjetër, apo që i kanë mësuar më herët këta nxënës, si dhe të gjithë ata që në një mënyrë apo tjetër mund të ofrojnë ndihmë.

Pyetjet hulumtuese

1. Cilat janë sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në orë mësimore?
2. Si i perceptojnë mësimdhënësit dhe nxënësit këto sjellje?
3. Si menaxhohen sjelljet e papërshtatshme të nxënësve nga mësuesit?

METODOLOGJIA

Modeli i hulumtimit

Qasja sasiore është përdorur në grumbullimin e të dhënave. Studimi ishte përshkrues dhe vlerësues. Të dhënat sasiore u morën nga mësimdhënësit dhe nxënësit.

Popullata dhe mostra

Popullatën e përbëjnë mësimdhënës të SHFMU dhe nxënës. Mostra (N=93) mësimdhënës të shkollave të Kosovës dhe (n=103) nxënës të klasave VII-IX.

Instrumentet dhe metodat

- **Metoda e analizës së burimeve** - Për nevojat e këtij hulumtimi, janë shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme teorike, kryesisht të autorëve të jashtëm, por edhe të atyre vendorë.

- **Metoda e anketimit** - Me përdorimin e kësaj metode janë grumbulluar të dhënat për perceptimet e mësimeve dhe të nxënësve.

Instrumentet e hulumtimit

- Për grumbullimin e të dhënave si instrument bazë është përdorur pyetësi. Pyetësi përmbante të dhënat demografike të mësimeve, pyetje të hapura, me alternativa dhe pyetje të mbyllura, si dhe ishte anonim.

Procedura e mbledhjes së të dhënave

- Janë lajmëruar drejtorët e shkollave, përmes e-mailit, lidhur me realizimin e pyetësit me mësime të lëndëve të ndryshme, të cilët japin mësim në klasë të teta dhe të nënta. Gjithashtu janë njoftuar lidhur me metodën e plotësimit përmes Google form apo e-mailit.
- Po ashtu, pyetësi në Google form është publikuar edhe tek ueb-faqja ‘Mësimet në Kosovë’ dhe ‘Mësimet parauniversitare’, ku janë edhe grupe të mësimeve, dhe është realizuar plotësimi i masës më të madhe, por kishte dhe numër të atyre që kërkonin versionin në Word, përmes e-mailit, dhe e kthenin të plotësuar.

Procedura e analizës së të dhënave

- Është realizuar analiza e statistikave përshkuese, si përqindja, sipas përbërjes demografike të mostrës dhe sipas të dhënave në pyetësor.
- Analiza e të dhënave cilësore është bërë sipas parimit të ideve dhe koncepteve kryesore. Për të fuqizuar të dhënat sasiore bëhet ndërlidhja me përgjigjet cilësore nga pyetësorët e plotësuar.

REZULTATET E ANALIZËS SË TË DHËNAVE NGA PYETËSORËT E MËSIMDHËNËSVE

Mësimdhënës të përfshirë në hulumtim ishin 93, të cilët u përgjigjën në pyetësinorin përmes Google form 60 nga ta dhe 33 përmes postës elektronike.




Fig. 1. Struktura e mostrës sipas gjinisë

Të dhënat biografike të pjesëmarrësve, siç shihet nga grafiku, 86.7% e atyre që plotësuan pyetësinorin ishin femra, ndërsa 13.3% e tyre mësimdhënës meshkuj.




Fig. 2. Mosha e pjesëmarrësve në mostër

Sa i përket moshës së përfshirë në hulumtim, 40% e tyre ishin mes 36 deri në 45 vjeç. Ndërsa 36% e tyre ishin 26 deri në 35 vjeç, që 1% të kuptohet vetë plotësimi i pyetësorit online te mosha më e re është procedurë më e lehtë. Mosha 46 deri në 56 vjeç ishin 15% dhe vetëm 7% e tyre mbi 56 vjeç.




Fig. 3. Përgatitja profesionale

Përgatitja profesionale e mësime dhënëse të përfshirë është 70% me kualifikimin mastër/magjistër dhe 30% me fakultet ose bachelor.




Fig. 4. Përvoja në arsim

Vërehet se numri më i madh i tyre, më 40%, kanë nga 7 deri në 18 vjet përvojë pune në arsim, 18.3% e tyre nga 19 deri në 30 vjet përvojë pune dhe kemi me më pak përvojë 21.70% e tyre nga 4 deri në 6 vjet dhe 20% e tyre deri në 3 vjet përvojë pune në arsim.




Fig. 5. Cikli në të cilin mësime japin mësime

Meqenëse pyetësi është publikuar online, përmes Google form, dhe u është dedikuar vetëm mësimeve të ciklit 1-9, ne kemi marrë përgjigje edhe nga cikli fillor, me 14% të tyre. D.m.th. klasa 1 deri 5 dhe 78% e tyre është plotësuar nga mësime që japin mësime në ciklin e mesëm të ulët, 1 deri në 9, dhe 8% e tyre cikël të mesëm të lartë.





Fig. 6. Llojet e sjelljes së nxënësve në klasë

Në pyetjen çfarë janë sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në orë mësimore, 61% e mësimdhënësve mendojnë se është plotësisht e vërtetë se gjuha urrejtëse ofenduese është sjellje e papërshtatshme e nxënësve në orë mësimore, ndërsa kemi 21% që mendojnë se kanë dilema lidhur me këtë. 56% e tyre mendojnë se edhe mashtrimet e kopjimet janë plotësisht të vërteta, ndërsa 11% mendojnë se nuk është aspak e vërtetë, kurse 36% e tyre konsiderojnë se edhe bisedat anësore dhe përdorimi i telefonave janë sjellje të papërshtatshme dhe 13.8% mendojnë se nuk është aspak e vërtetë. Pastaj, kemi 53% të tyre që mendojnë se është plotësisht e vërtetë se janë lëvizjet e shpërqëndruara dhe 43% e tyre thonë se kanë dilema, 43% e tyre pajtohen plotësisht se çdo material i shkruar ofendues mund të konsiderohet sjellje papërshtatshme, 21.5% e tyre thonë se është e vërtetë, 78% e tyre pajtohen plotësisht se ngacimet e shokëve janë sjellje të papërshtatshme, ndërsa 9.8 % e tyre kanë dilema, 66% e tyre pajtohen plotësisht dhe mendojnë se zhurma në klasë është sjellje e papërshtatshme, mirëpo 1.7% e tyre thonë se nuk është e vërtetë. Vetëbesimi i tepruar, 44% pajtohen plotësisht, por kemi edhe 6% që konsiderojnë se nuk është aspak e vërtetë, vëmendja e padëshiruar janë përgjigjur 51% se është e vërtetë, ndërsa 2% mendojnë se nuk është aspak e vërtetë dhe komunikimet e zemëruara 41% e tyre dhe 10% mendojnë se nuk është e vërtetë.



Grafiku 7. Cilët nxënës janë më të predispozuar ndaj këtyre sjelljeve

Në pyetjen se cilët nxënës janë më të predispozuar ndaj këtyre sjelljeve, kemi këto përgjigje nga respondentët: 31% e tyre për stabilitetin ekonomik. Fëmijët nga shtëpitë me të ardhura të ulëta shpesh përjetojnë mungesë të qëndrueshmërisë së prindërve, një ndryshim i shpeshtë në kujdestarët me kohë të pjesshme, mungesë mbikëqyrjeje, ushqyerje të dobët dhe modelim të dobët të roleve kanë dilemë se kjo mund të jetë predispozitë, ndërsa 19% mendojnë se është e vërtetë, e po ashtu kemi 23% që mendojnë se nuk është e vërtetë.

Sa u përket ndryshimeve në marrëdhëniet familjare, divorci ka qenë prej kohësh i lidhur me problemet e sjelljes, ankthit dhe depresionit te fëmijët. Kjo ndodh shpesh, për shkak se shtëpitë me prindër të vetëm kanë prindër që luftojnë me ndjenjat e tyre të depresionit dhe ankthit, duke përmbushur përgjegjësitë shtëpiake të mbajtura më parë nga dy persona dhe plotësojnë më shumë kërkesa financiare. Kemi 31% të tyre që mendojnë se këta fëmijë janë më të predispozuar të kenë sjellje të papërshtatshme, po ashtu edhe 27% mendojnë se plotësisht i vërtetë është ky shkas.

Qëndrimet e prindërve drejt arsimit - Fëmijët mësojnë së pari duke imituar sjelljen që ata e shohin të modeluar për ta. Fëmijët me prindër që inkurajojnë suksesin akademik kanë më shumë të ngjarë të zhvillojnë aspiratat e tyre për arsim të lartë. Në këtë mënyrë, edukimi i prindërve është një parashikues i mirë i suksesit akademik të një fëmije dhe kemi këto përgjigje: pajtohen 41% e tyre se kjo është e vërtetë dhe 5% konsiderojnë se është e pavërtetë.

Komuniteti në të cilin jeton nxënësi mund të jetë i çorganizuar nga shoqëria, 38% e tyre mendojnë se është plotësisht e vërtetë, ndërsa 6% konsiderojnë se nuk është e vërtetë.

Mediet - Adoleshentët janë mijëvjeçarë dhe për këtë arsye jeta e tyre e përditshme në shtëpi, në shkollë dhe madje edhe në grupe të kolegëve, është e drejtuar nga teknologjia. Media e re dominon jetën e tyre mendojnë 51% se është e vërtetë dhe 2% aspak e vërtetë.

Sa u përket karakteristikave biografike dhe demografike, kemi 33% që mendojnë se nuk është aspak e vërtetë, ndërsa 19% konsiderojnë se është e vërtetë.

Po ashtu, edhe aftësitë intelektuale dhe fizike - Probleme të ndryshme fizike, nevojat e veçanta, mendojnë 67% se kjo është plotësisht e vërtetë dhe 2.90% e konsiderojnë si aspak të vërtetë.




Fig. 8. Mosha problematike e nxënësve për paraqitjen e sjelljeve

Sa i përket moshës problematike, kemi 49% e atyre që mendojnë se mosha 14 deri 16 vjeç është mosha më problematike, apo mosha kur ka më së shumti sjellje të papërshtatshme. Po ashtu, edhe mosha 12-14 vjeç konsiderohet si moshë problematike në 23% të përgjigjeve të tyre. Ndërsa 17% mendojnë se mosha 16-18 vjeç është moshë problematike dhe kemi 11% që mendojnë se edhe mosha 10 deri 12 vjeç mund të kenë sjellje të papërshtatshme, që konsiderohen problematike.




Fig 9. Disa nga shkaqet e sjelljeve të papërshtatshme mund të jenë

Se cilat mund të jenë shkaqet që shtyjnë një nxënës të bëjë sjellje të papërshtatshme, kemi paraqitur disa alternativa që mësimdhënësit janë përgjigjur: 29% e respondentëve mendojnë se kanë probleme me kurrikulën, ndërsa 17% mendojnë se kjo nuk është e vërtetë. Sa i përket mjedisit në klasë si shkak, 28% mendojnë se është e vërtetë se mund të jetë shkak i sjelljeve të papërshtatshme, ndërsa 13% e tyre konsiderojnë se kjo është e pavërtetë.

Faktorët fiziologjikë, 54% e tyre përgjigjen së është e vërtetë që janë shkak, ndërsa 2% konsiderojnë se është e pavërtetë. Po ashtu, edhe mungesa e vetëbesimit ndikon tek ata. 47% e tyre mendojnë se është e vërtetë, ndërsa 2% e pavërtetë. 25% e mësimdhënësve mendojnë se e bëjnë edhe për hakmarrje, ndërsa 15% e tyre mendojnë së kjo nuk është e vërtetë. Dëshira për fuqi 40% konsiderojnë se është e vërtetë, ndërsa 2% e pavërtetë. Duke kërkuar vëmendje, 56% e tyre konsiderojnë se është plotësisht e vërtetë, ndërsa 2.9% e tyre mendojnë se është e pavërtetë.




Fig. 10. Strategjitë parandaluese të sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve janë këto

56% e tyre mendojnë se është e vërtetë që menaxhimi i klasës kërkimore në një masë të madhe është ndër strategjitë parandaluese për sjellje të papërshtatshme, ndërsa 6% mendojnë se kjo nuk është e vërtetë. Përdorni afërsinë fizike për të frenuar sjelljen e keqe. Nëse dy nxënës janë duke folur, ndërsa jeni duke u përpjekur të flisni, thjesht vazhdoni ato që po thoni, por afrohuni më pranë nxënësve, pasi 55% e tyre konsiderojnë se kjo është e vërtetë, 31% e tyre se është plotësisht e vërtetë dhe 14% konsiderojnë se është e pavërtetë. Mbajini nxënësit të zënë dhe të angazhuar në materiale. Sa më shumë që të jetë e mundur, nxënësit duhet të kenë ndjenjën se ajo që po mësojnë është interesante dhe e rëndësishme, 63.8% mendojnë se kjo është plotësisht e vërtetë, ndërsa 27% mendojnë se është e vërtetë dhe kemi 8% që mendojnë se nuk është e vërtetë. 51% e tyre mendojnë se është e vërtetë si strategji përdorimi i përgjigjeve pozitive për sjellje pozitive. Të treguarit dhe shpërblimi i sjelljes së mirë mund të jenë një mënyrë efektive për të ulur sjelljen e keqe. 38% e mësimdhënësve mendojnë se është plotësisht e vërtetë dhe 11% konsiderojnë se kjo nuk është e vërtetë. Nga përgjigjet e respondentëve, kemi 76% të atyre që konsiderojnë se është e vërtetë se strategjia e arritjes në rrënjë të problemit mund të përfshijë një bisedë me nxënësin, por edhe të shokëve të tij dhe familjes, dhe 19 % mendojnë se është plotësisht e vërtetë.

Të identifikoni problemin e saktë. Pretendimi se një nxënës "ka një qëndrim të keq" është shumë i paqartë për t'u trajtuar me lehtësi 56% e tyre thonë se është e vërtetë, ndërsa 37% plotësisht e vërtetë dhe kemi 7% aspak e vërtetë. 46% e tyre mendojnë se kjo është plotësisht e vërtetë si strategji. T'i njihni mirë nxënësit tuaj. Njohja e personaliteteve, aftësive dhe prejardhjeve të tyre, mund të përmirësojë shumë vendimmarrjen tuaj. Pastaj kemi 71% që mendojnë se është e vërtetë nëse organizoni vetë klasën. Dhoma duhet të jetë pa shpërqendrim të panevojshme, të jetë në rregull. Kjo duhet të ndihmojë në mirëmbajtjen e përqendrimit të nxënësve, ndërsa 22% është plotësisht e vërtetë dhe 5.6% që konsiderojnë se kjo nuk është aspak e vërtetë.

76% e respondentëve thonë se është e vërtetë si strategji e përdorur vendosja e një grupi rregullash dhe dënimesh të përcaktuara qartë. Nëse nxënësit e dinë saktësisht se çfarë pritet prej tyre dhe saktësisht çfarë do të ndodhë nëse

veprojnë jashtë, ka më pak të ngjarë të shkaktojnë probleme, ndërsa 11% mendojnë se është plotësisht e vërtetë dhe 5% aspak e vërtetë.

54% e përgjigjeve janë se është e vërtetë se ndikon krijimi i një atmosfere pozitive, mbështetëse, në klasë. Nxënësit kanë më shumë të ngjarë të "ndjekin udhëzimet, të punojnë shumë dhe të shfaqin sjellje pozitive në klasë kur ndihen të kërkuar dhe të vlerësuar nga mësuesi", 35% e tyre mendojnë se është plotësisht e vërtetë dhe 11% kanë dilema lidhur me këtë strategji.

REZULTATET E ANALIZËS SË TË DHËNAVE NGA PYETËSORËT E NXËNËSVE

Nxënës të përfshirë në hulumtim ishin 103, po ashtu e plotësuan pyetësorin online përmes Google form, por edhe përmes e-mailit/postës elektronike.




Fig. 11. Mostra e nxënësve sipas gjinisë

Të dhënat biografike të pjesëmarrësve, siç shihet nga grafiku 56.7% që e plotësuan pyetësorin ishin femra, ndërsa 43.3 % meshkuj.




Fig. 12. Mostra e nxënësve sipas moshës

Nga figura 12 vërehet se 56% e nxënësve që plotësuan pyetësoin ishin të moshës 14 deri në 15 vjeç, 29% ishin 12 deri në 13 vjeç dhe 12% e tyre nxënës të moshës 15 deri 16 vjeç.




Fig. 13. Mostra sipas nivelit të shkollimit të nxënësve

Sa i përket nivelit të shkollimit ku ata janë nxënës, 87% e tyre janë përgjigjur se janë në ciklin e mesëm të ulët, klasat 6-9, kurse 12% në ciklin e mesëm të lartë, klasat 10-12, dhe 1.20% në ciklin fillor, klasat 1-5.




Fig. 14. Vlerësimi nga ana e nxënësve i sjelljeve të papërshtatshme

Në pyetjen çfarë janë sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në orë mësimore, 32% e nxënësve mendojnë se gjuha urrejtëse (ofenduese) është sjellje e papërshtatshme e nxënësve në orë mësimore, ndërsa 22% mendojnë se është plotësisht e vërtetë, ndërsa 18% e tyre mendojnë se nuk është aspak e vërtetë. 28% mendojnë se edhe mashtrimet e kopjimit është e vërtetë se janë sjellje të papërshtatshme, ndërsa 13.6% kanë dilema nëse kjo është sjellje e papërshtatshme ose jo, 39% e tyre konsiderojnë se janë edhe bisedat anësore sjellje të papërshtatshme në orë mësimore, 28% kanë dilema dhe 4% konsiderojnë se nuk është aspak e vërtetë.

Përdorimi i telefonave sipas përgjigjeve të 56% të tyre konsiderohet sjellje e papërshtatshme, 21% e tyre kanë dilema dhe 1% mendojnë se nuk është aspak e vërtetë. Pastaj, 39% shprehen se është e vërtetë se lëvizjet e shpërqendruara janë sjellje të papërshtatshme, 29% konsiderojnë se nuk është aspak e vërtetë, 18% kanë dilema dhe 4% mendojnë se nuk është aspak e vërtetë.

Ndërsa, 42% mendojnë se çdo material i shkruar ofendues mund të konsiderohet sjellje e papërshtatshme, 16% e tyre thonë se është plotësisht e vërtetë, 11% e tyre kanë dilema dhe 16% konsiderojnë se nuk është e vërtetë aspak. Ngacmimet e shokëve 46% e tyre mendojnë se është plotësisht e vërtetë se janë sjellje të papërshtatshme, 23% se është e vërtetë, 16% që kanë dilema dhe 2% se nuk është e vërtetë aspak. Zhurma në klasë 54% pajtohen plotësisht se është sjellje e papërshtatshme, 17% kanë dilema, 16% se është e vërtetë dhe 7% nuk pajtohen aspak. Vetëbesimi i tepruar 56% nuk pajtohen aspak, 18% thonë se është e vërtetë, por 9% kanë dilema dhe 5% e pavërtetë, ndërsa te vëmendja e padëshiruar janë përgjigjur 26% se është e vërtetë, 15% kanë dilema, 21% mendojnë se është plotësisht e vërtetë dhe 24% e pavërtetë. 52% e tyre mendojnë se është plotësisht e vërtetë se komunikimet e zemëruara janë sjellje të papërshtatshme, 22% kanë dilema, 12% mendojnë se është e vërtetë dhe 11% mendojnë se është e pavërtetë dhe 41% mendojnë se nuk është aspak e vërtetë.




Fig. 15. Shkaqet që shtyjnë një nxënës të bëjë sjellje të papërshtatshme

Se cilat mund të jenë shkaqet që shtyjnë një nxënës të bëjë sjellje të papërshtatshme, kemi paraqitur disa alternativa që nxënësit janë përgjigjur: 52% e tyre pajtohen se është e vërtetë se kërkojnë vëmendje kur bëjnë sjellje të tilla, 22% kanë dilema, 11% nuk pajtohen se është e vërtetë dhe kemi 3% që e konsiderojnë të pavërtetë. Te dëshira për fuqi 26% e tyre thonë se është plotësisht e vërtetë, 24% konsiderojnë se nuk është aspak e vërtetë, 15 % shprehen se kanë dilema dhe 13% mendojnë se është e pavërtetë. 56% e tyre mendojnë se kjo nuk është aspak e vërtetë se mund të bëhet për hakmarrje sjelljet e papërshtatshme, 5% e tyre kanë dilema, 12% mendojnë se është e vërtetë dhe kemi 9% që pajtohen plotësisht se është e vërtetë. Te mungesa e vetëbesimit kemi këto përgjigje: 54% pajtohen plotësisht se është e vërtetë, 17% kanë dilema, 16% është e vërtetë dhe 6% nuk pajtohen aspak me këtë gjë. Mjedisi në klasë 46% mendojnë se plotësisht është e vërtetë se mund të jetë shkas i sjelljeve të papërshtatshme, 23% mendojnë se është e vërtetë dhe 13% kanë dilema, 7% që është e pavërtetë dhe 6% nuk pajtohen se është aspak e vërtetë.

Probleme me mësimin kemi 42% që mendojnë se është e vërtetë, 11% kanë dilema, 15% e pavërtetë dhe 16% e tyre mendojnë se nuk është e vërtetë aspak. Mospëlqimi i mësimdhënësit 39% mendojnë se është e vërtetë, 29% plotësisht e vërtetë, ndërsa kemi 18% që kanë dilema, 9.7% e pavërtetë dhe 4% nuk është aspak e vërtetë.

Atmosfera jo e kënaqshme në klasë, 56% e tyre mendojnë se kjo është e vërtetë, 21% kanë dilema, 18% konsiderojnë se është e pavërtetë, 4% plotësisht e vërtetë dhe 1% mendojnë se nuk është aspak e vërtetë. Mësimdhënësi bën dallime ndërmjet nxënësve 39% thonë se është e vërtetë, 28% e tyre kanë dilema, 16% mendojnë se kjo nuk është aspak e vërtetë dhe 4% konsiderojnë se është plotësisht e vërtetë. Problemet me familje, 27% mendojnë se është plotësisht e vërtetë, 28% mendojnë se është e vërtetë ndërsa 13.6% kanë dilema, 21% aspak e vërtetë dhe 9 % e pavërtetë.

Nuk më pëlqen klasa, shokët dhe shoqet, 32% mendojnë se kjo është e vërtetë, 22% plotësisht e vërtetë, 18% aspak e vërtetë dhe 17% kanë dilema. Nuk ndihem mirë në shoqëri si shkak i sjelljeve të papërshtatshme, 45% e

tyre pajtohen së kjo është e vërtetë, 22% plotësisht e vërtetë, 14% aspak e vërtetë dhe 12% e tyre kanë dilema.

Tek alternativa më përqeshin shokët si vishem janë përgjigjur 53% e tyre se është e vërtetë, 25% plotësisht e vërtetë, 12% kanë dilema dhe 6% nuk pajtohen aspak që është e vërtetë.




Fig. 16. Menaxhimi sjelljeve nga mësuesit në perceptimet e nxënësve

Në pyetjen si menaxhohen sjelljet e papërshtatshme të nxënësve nga mësuesit, kemi këto përgjigje nga ana e nxënësve: 54% thonë se hakmerren me notë në vlerësim me plotësisht e vërtetë, 21% thonë se është e vërtetë hakmarrja, ndërsa 9% kanë dilema dhe 11% thonë se nuk është aspak e vërtetë se ka hakmarrje në nota. Sa i përket injorimit nga ana e mësimeve, 33% pajtohen plotësisht se është e vërtetë se ka injorim, 21% se është e vërtetë, 13% kanë dilema dhe 21% konsiderojnë se nuk është aspak e vërtetë. Shmangen, anashkalohen kur bie fjala për favorizim ose shpërblim, pavarësisht suksesit të shkëlqyeshëm, 56% e tyre shprehen me plotësisht e vërtetë, 19% shprehen se është e vërtetë, ndërsa 12% kanë dilema dhe 13% shprehen se aspak nuk është e vërtetë. Sa u përket dënimeve të nxënësve, 56% shprehen se është e vërtetë, 19% e tyre se është plotësisht e vërtetë dhe 13% kanë dilema, ndërsa 12% e tyre se nuk është aspak e vërtetë se ka dënime për nxënës. Tek alternativa menaxhimi i klasës me angazhim në mësim dhe jo muhabet 56% e tyre shprehen se është plotësisht e vërtetë, 38% e tyre konsiderojnë se është e vërtetë dhe 6% kanë dilema. Përdorin afërsinë fizike për të frenuar sjelljen e keqe 55% e tyre pajtohen se është e vërtetë, 31% e vërtetë dhe 14% e tyre kanë dilema.

I mbajnë nxënësit të zënë dhe të angazhuar në materiale 63.8% pajtohen plotësisht e vërtetë, 27% konsiderojnë se është e vërtetë dhe 8% kanë dilema lidhur me këtë çështje. Përdoren përgjigje pozitive për sjellje pozitive 51% pajtohen se është e vërtetë, 31% pajtohen se plotësisht e vërtetë dhe 11% kanë dilema. Ndërsa, sa i përket arritjes në rrënjë të problemit, ku mund të përfshijë një bisedë me nxënësin, por edhe të shokëve të tij dhe familjes, 76% e tyre pajtohen se kjo është e vërtetë, 19% pajtohen se është plotësisht e vërtetë si zgjidhje e mirë. Tek identifikoni problemin e saktë, pretendimi se një nxënës "ka një qëndrim të keq" është shumë i paqartë për t'u trajtuar me lehtësi, ku 56% pajtohen se është e vërtetë, 37% e tyre pajtohen plotësisht dhe 7% kanë dilema.

Te na njohin mirë. Njohja e personaliteteve, aftësive dhe prejardhjeve të tyre, mund të përmirësojë shumë vendimmarrjen tuaj, 46% pajtohen plotësisht e vërtetë, 34% pajtohen se është e vërtetë 13% kanë dilema dhe 7% nuk pajtohen aspak. Tek alternativa të organizohet klasa bashkë me ne kemi 71% që pajtohen se është e vërtetë, 22% plotësisht e vërtetë dhe 5.6%

kanë dilema. Vendosja e një grupi rregullash dhe dënimesh të përcaktuara qartë 71% pajtohen se është e vërtetë, 11% plotësisht e vërtetë dhe 6.7 % kanë dilema, ndërsa 5% nuk pajtohen aspak. Krijimi i një atmosfere pozitive, mbështetëse në klasë 54% pajtohen se është e vërtetë, 35% plotësisht e vërtetë dhe kemi 11% që kanë dilema.

PËRFUNDIME

Gjetjet e këtij hulumtimi do të jenë në ndihmë të drejtuesve të shkollave dhe mësimeve në mënyrë që të mund të parandalojnë dhe menaxhojnë sa më mirë sjelljet e papërshtatshme të nxënësve në orë mësimore, duke realizuar edhe menaxhimin e klasës pa lënë hapësirë dhe kohë për sjellje të tjera. Me sjellje jo të mira ndeshet pothuajse çdo ditë mësimeve dhe detyra e tij është që të gjejë gjuhën e përbashkët me atë nxënës që shkakton sjellje problematike në klasë. Nëse mësimeve arrijnë ta ndalojnë shfaqjen e kësaj sjelljeje, atëherë mund të them se ndërhyrja e tij do të kishte rezultat pozitiv. Por, që kjo të ndodhë mësimeve duhet të bëjnë vlerësimin e sjelljes, duke parë përtej asaj që nxënësi shfaq, për të kuptuar arsyet e ndodhjes së kësaj sjelljeje. Siç shprehet Theodor Karaj në librin “Menaxhimi i klasës” (2008), në kapitullin

Vlerësimi i sjelljes dhe ndërhyrjet lidhur me të në klasë: “Të gjitha tipat e sjelljeve mësohen. Shumica e sjelljeve shërbejnë për një qëllim ose përmbushin një nevojë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për sjelljet problematike. Kur mësuesit vlerësojnë sjelljen problematike të nxënësve për të përcaktuar qëllimin e saj, atëherë ato i krijojnë vetes mundësinë që të ndërhyjnë në mënyrë efektive për të përmirësuar sjelljen e nxënësit”.

Nga rezultatet e hulumtimit u vu në pah se puna e mësimeve, metodat dhe strategjitë e tij, janë faktorë të rëndësishëm të jetës shkollore. Faktorë tjerë janë metodat, teknikat dhe strategjitë që përdor mësuesi për të stimuluar nxënësit në mësim dhe për t'i adaptuar në klasë dhe shoqëri. Mjedisi fizik është i rëndësishëm në motivimin e nxënësve, sepse krijon kënaqësi dhe dëshirë për të kaluar një pjesë të konsideruar të ditës në shkollë dhe parandalon sjelljet jo të këndshme e të papërshtatshme të nxënësve. Mësimeve që punojnë me motivim ua transmetojnë edhe nxënësve të

tyre, duke i bërë të ndihen të rëndësishëm e të vlefshëm, duke ua bërë të mundur një adaptim më të lehtë në klasë nxënësve që kanë sjellje të papërshtatshme.

REKOMANDIME

- Të hartohet një program trajnimi për menaxhimin dhe parandalimin e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve në shkollë dhe klasë mësimore;
- T’u ofrohet mbështetje shtesë mësimdhënësve në klasat me numër më të madh të nxënësve në klasë kur identifikohen më shumë sjelljet e papërshtatshme të tyre;
- DKA-të të ofrojnë kushte më të përshtatshme, si dhe ndihmë për këta nxënës, në mënyrë që të kontribuojnë për përmirësimin, motivimin dhe ngritjen e tyre;
- Të kenë bashkëpunim me MASH-in, IPK-në dhe institucionet e tjera përkatëse për të paraqitur pengesat dhe sfidat që ndikojnë në edukimin e fëmijëve me sjellje devijuese të papërshtatshme, në mënyrë që të kenë mbështetje institucionale për tejkalimin e këtyre sfidave;
- Mësimdhënësit t’u ndihmojnë nxënësve që të qëndrojnë të motivuar gjatë orëve të mësimi; Motivimi është një nga sfidat më të mëdha me të cilat po përballlet arsimi sot;
- Mësimdhënësit të jenë të trajnuar, të përkushtuar, të përgjegjshëm dhe të kenë një kujdes më të veçantë për këta nxënës, të tregojnë entuziazëm gjatë procesit mësimor.
- Mësuesit duhet të jenë ata që furnizojnë nxënësit, duke u dhënë detyra sfiduese dhe duke i ndihmuar të zhvillojnë aftësi për të mësuar dhe vetëdrejtuar.
- Drejtorët e shkollave, në bashkëpunim me mësuesit, prindërit, stafin profesional të shkollës dhe nxënësit duhet të hartojnë programe të përfshirjes dhe bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet, t’i zbatojnë,

t'i monitorojnë dhe t'i rishikojnë ato së bashku në mënyrë të vazhdueshme. Nxënësve duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë, pasi roli i tyre është kryesor në suksesin e këtyre programeve.

Referencat

1. Burden, P., R. (1995). Classroom management and discipline. New York: Longman Byrne, M (1994). Managing Pupil Behaviour: Key Issues in Teaching and Learning. London: Routledge.
2. Cangelosi, J., S. (2008). Classroom management strategies. Gaining and maintaining students' cooperation (5th Ed.). New Jersey:
3. Frank M. Weerman, Paul Harland, Peter H. van der Laan(2007). Misbehavior at School and Delinquency Elsewhere: A Complex Relationship, <https://doi.org/10.1177/0734016807311905>
4. H. L. Johnson and H. L. Fullwood (2006), "Disturbing behaviors in the secondary classroom: how do general educators perceive problem behaviors?" Journal of Instructional Psychology, vol. 33, no. 1, pp. 20–39,
5. Hirschi, T., & Gottfredson M. R. (1994). The generality of deviance. New Brunswick, NJ:
6. Karaj, Theodor (2008). Menaxhimi i klasës, Tiranë.
7. Longman. Hayden, C. (2007). Children in Trouble. Basingstoke Palgrave Macmillan Hollin, C. (1993). Management of Behaviour in Schools. London:
8. Lewis, T. J., Sugai, G., & Colvin, G. (1998). Reducing problem behavior through a school-wide system of effective behavioral support: Investigation of a school-wide social skills training program and contextual interventions. School Psychology Review, 27(3), 446.
9. Leung, P. , Kwong, S.L. , Tang, C.P. , Ho, T.P. , Hung, S.F. , Lee, C.C. , et al. (2006). Test-retest reliability and criterion validity of the Chinese version of CBCL, TRF, and YSR. Journal of Child Psychology and Psychiatry, and Allied Disciplines, 47, 970—973.
10. Lewis, R., Romi, S., Qui, X., & Katz, Y. J. (2005). Teachers' classroom discipline and student misbehavior in Australia, china and Israel. Teaching and Teacher Education, 21(6), 729-741.
11. Mohamed O., R. (2012). Classroom management and supervision. African Virtual University: Creative Commons.

12. Reed, D. F., & Kirkpatrick, C. (1998). Disruptive students in the classroom: A review of the literature. Richmond, VA: Metropolitan Educational Research Consortium
13. Pearson Kohli, T., K. (1999). Characteristic and Environmental correlates of Academic Achievement. *Global Journal of Management and Research Business Research*, 12(6), 17-22. Retrieved from [http: // creative commons.org](http://creativecommons.org)
14. Walker, H., Colvin, G., & Ramsey, E. (1995). Antisocial behavior in public school: Strategies and best practices. Pacific Grove, CA: Brookes/Cole.
15. Wang, H., K. (2012). There Is Only Way to Improve student Achievement. *American Journal of Sociology*, 4(7), 541-557.
16. Wiley and Sons. Chambers, G., N. (1999). *Motivating Language Learners: Moderns Languages in Practice* 12. N.P: Multilingual Matters LTD.